

VENDIM
Nr. 72, datë 1.10.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TARIFE TË SHOQËRISË SË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE KRUIJË**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42), Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 1.10.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

konstatoi se:

Shoqëria e Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 18, datë 5.5.2017, “Për licencimin e Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë” pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria e Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë ka aplikuar pranë ERRU-së me shkresën nr. 1252 prot., datë 28.6.2018, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Krujë kishte mangësi në dokumentet “Pasqyrat financiare 2017” dhe “Raporti i ekspertit kontabël”.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 337/2 prot., datë 20.7.2018, për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Krujë, me shkresën nr. 1447 prot., datë 18.9.2018, ka dërguar dokumentacionin e munguar “Pasqyrat financiare 2017” dhe “Raporti i ekspertit kontabël”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Krujë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë së Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë e Ujësjiellës-Kanalizimeve Krujë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani